



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT-ODBOR ZA USLOVNI OTPUST-CONDITIONAL RELEASE PANEL

PLK. D. nr. 650/23

PANELI PËR LIRIM ME KUSHT, i përbërë nga Valdete Daka, kryesuese e Panelit, Burim Ademi dhe Argjira Asllani, anëtar të panelit, me pjesëmarrjen e Mersime Mehmeti, u.d. koordinatorë e panelit për lirim me kusht, duke vendosur përkitazi me kërkesën për lirim me kusht, të parashtruar nga i dënuari L. M., për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 28 të KPRK-së dhe Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje në vazhdimësi nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 dhe par. 2 nën par. 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, i gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 8 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 400€, me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, P.nr.10/2022, i datës 08.02.2022, pas shqyrtimit të kërkesës për lirim me kusht, në pajtim me nenin 90 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi nr. 06-L-074), nenin 116, 117 dhe 118 par. 4 të Ligjit (08/ L-132) për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, dhe nenet 12, 13, 14, 18, 22, 25 par.1 pika 1.2 dhe nenin 33 të Rregullores së miratuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Ref: KGJK, nr. 01/39) mbi Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht, në seancën e mbajtur me datë 07.12.2023, në selinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës në Prishtinë, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET kërkesa për lirim me kusht e të dënuarit L. M. nga i ati F. dhe e ëma A., e gjinisë M., i lindur me datë ..., me vendbanim në rr. "...", Komuna R., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

II. Kërkesa për lirim me kusht i refuzohet për periudhën kohore prej 9 muaj, e njëjta mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore Gjakovë – Dega Rahovec, P.nr.10/2022, i datës 08.02.2022, L. M. është shpall fajtor për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 28 të KPRK-së dhe Vjedhje e rëndë

në bashkëkryerje në vazhdimësi nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 dhe par. 2 nën par. 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së, i gjykuar me dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 3 vite, 8 muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 400€.

Me datë 30.10.2023, i dënuari e ka parashtruar kërkesën për lirim me kusht përmes Institucionit të Qendrës Korrektuese ku është në vuajtje të dënimit me burg, me arsyetimin se gjatë vuajtjes së dënimit, me sjelljet e tij është arritur risocializimi i tij dhe janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për lirin e tij me kusht.

Paneli për lirim me kusht në seancën e mbajtur me datën 07.12.2023 pasi e shqyrtoi kërkesën e të dënuarit, dosjen e tij, raportin përmbledhës të përpiluar nga Ekipi Profesionist i Shërbimit Korrektues të Kosovës, Deklaratën-premtimin lidhur me mbikëqyrjen e të dënuarit pas lirimimit me kusht, ashtu siç është përcaktuar në nenin 116 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale nr.08/L-132, dhe pas vlerësimit të tërësishëm të çështjes gjeti se:

Kërkesa për lirim me kusht është e **pabazuar**.

Nga shkresat e çështjes, dosja e të dënuarit, rezulton se i njëjti është shpallur fajtor për shkak të veprave penale Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje në tentativë nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 31 dhe nenin 28 të KPRK-së dhe Vjedhje e rëndë në bashkëkryerje në vazhdimësi nga neni 315 par. 1 nën par. 1.1 dhe par. 2 nën par. 2.2 lidhur me nenin 31 dhe 77 të KPRK-së.

Në raportin ligjor për të dënuarin vërtetohet se i dënuari lirim normal e ka me datë 14.09.2025 dhe nga llogaritja e dënimit deri më tani rezulton se i ka vuajtur 1 vit, 10 muaj, 21 ditë, ndërsa i kanë mbetur edhe 1 vit, 9 muaj, 7 ditë. Në raportet e tjerë të përpiluara nga Ekipi profesionist i Qendrës Korrektuese, konstatohet se i dënuari gjatë vuajtjes së dënimit ka treguar sjellje të mirë dhe i angazhuar në punë. Ndërsa për procesin e risocializimit është konstatuar se burgu ka efekt pozitiv te i dënuari.

Gjatë shqyrtimit të kërkesës së të dënuarit për lirim me kusht, Paneli ka vlerësuar kushtet për lirim me kusht, të përcaktuara në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, duke përfshirë kriteret e parashikuara në Rregulloren 01/39 mbi Organizimin dhe Funkcionimin e Panelit për lirim me kusht. Kriteret përfshijnë: peshën e krimit, historinë e kaluar kriminale, përshkrimin e personit të dënuar për krimin, qëndrimin ndaj viktimës, sjelljen gjatë burgimit, gjendjen psikiatrike dhe psikologjike, gjendjen fizike, historinë sociale, planet pas lirimimit, pranimin e kontrollit dhe ndihmën nga Shërbimi Sprovues, ekzistencën e një rreziku të përgjithshëm për publikun, dhe perspektivën e një personi të dënuar me origjinë të huaj për të kthyer në shtëpi.

Paneli, pas shqyrtimit të kërkesës, vlerësimit të gjitha kushteve dhe kriterëve si më lartë, konstatoi se procesi i risocializimit ende nuk është i plotë, duke marr parasysh peshën e veprave penale të kryera nga i dënuari, ngase pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave tilla apo të ngjashme penale dhe historinë e kaluar penale, andaj bazuar në këto konstatime, Paneli vlerëson se qëllimi i ekzekutimit të sanksionit penal, sipas dispozitave të nenit 38 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe nenit 5 dhe 6 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është arritur, andaj kërkesa e personit të dënuar

është refuzuar për një periudhë kohore prej 9 muajve dhe mund të rishqyrtohet pas kalimit të këtij afati.

Nga sa u tha më lartë, në zbatim të nenit 25 pika 1.2 të Rregullores nr. 01/39 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**PANELI PËR LIRIM ME KUSHT
PLK. D. nr. 650/23, datë 07.12.2023**

U.d. Koordinatore e Panelit

Mersime Mehmeti

Kryesuese e Panelit

Valdete Daka

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 117 par. 16 të Ligjit Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nuk është e lejuar ankesa.